



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1094/6 prot.,

Datë 08.05.2025

V E N D I M
Nr. 638/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.05.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “M.C Catering” SHPK dhe “AGS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur Mbi Kufirin e Lartë Monetar, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë me të gjitha kushtet e përcaktuara”, me NR.REF-36976-02-06-2025, me objekt: “Blerje bulmet dhe nënproduktet e tij”, me fond limit 17,042,500 (shtatëmbëdhjetë milion e dyzet e dy mijë e pesëqind) lekë pa T.V.SH ose 171,903 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tre) Euro, zhvilluar më datë 10.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz

Ankimues: Operatori ekonomik “NELSA” SHPK me NIPT J71601012S dhe adresë: Lagjja Qesarak, rruga Tiranë-Dajt, Zona Kadastrale 2460, me Nr,Pasurie 199/32, Hyrja 1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kamëz
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori Ekonomik M.C.CATERING, me NIPT: K72218022J, Adresa: Rruga "Pjeter Budi", Nd.29, H3, Ap.14, Njësia Administrative nr.2, 1010 Tiranë

Operatori ekonomik "AGS" SHPK me NIPT: K62121038G
Adresa: Rruga "Faik Konica", Pallati "Golden Park Residence", Hyrja Nr. I, Kati Nr. 1, Zyra Nr. 2 Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi "NELSA" SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.03.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit Procedurë e hapur Mbi Kufirin e Lartë Monetar, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë me të gjitha kushtet e përcaktuara”, me NR.REF-36976-02-06-2025, me objekt: “Blerje bulmet dhe nënproduktet e tij”, me fond limit 17,042,500 (shtatëmbëdhjetë milion e dyzet e dy mijë e pesëqind) lekë pa T.V.SH ose 171,903 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tre) Euro, zhvilluar më datë 20.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 20.03.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 14.04.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “M.C.CATERING” SHPK	12,470,000	lekë kualifikuar
2. “A G S” SHPK	15,159,996	lekë kualifikuar
3. “NELSA” SHPK	15,370,000	lekë kualifikuar

II.4. Në datën 16.04.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “*Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraparak*” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5272, datë 25.04.2025 dhe me Nr. 1094/2025 Prot., datë 28.04.2025 e operatorit ekonomik “NELSA” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “M.C Catering ” SHPK dhe “AGS” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “*Për prokurimin Publik*” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1094/1 prot., datë 28.04.2025, me kriteret për të cilat operatori ekonomik “NELSA” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “M.C Catering ” SHPK dhe “AGS” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 3874/1 prot., datë 05.05.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1094/3 prot., datë 07.05.2025 me objekt “*Shkresë përcjellëse*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku

konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “NELSA” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NELSA” SHPK se:

“Referuar vlerësimit të kryer në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se oferta e shoqërisë tonë është e kualifikuar, ndërkohë që rezulton e kualifikuar oferta e dy operatorëve të tjerë ekonomikë, konkretisht operatorëve ekonomikë “M.C Catering” shpk dhe “AGS” shpk, për të cilët bazuar në dyshime të arsyeshme vlerësojmë se nuk përmbushin kriteret e kualifikimit dhe rrjedhimisht ofertat e tyre duhet të ishin skualifikuar. Në shtojcën për modifikimin e kriterëve të kualifikimit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik” i dokumentave standarte të tenderit është parashikuar se: “operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesin -raport/fletë analizë fiziko-kimike dhe raport/ fletë analizë mikrobiologjike, të lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi, të cilat të jenë të lëshuara brenda 3 muajve të fundit, para datës së hapjes së ofertave. Këto raport/fletë analiza duhet të paraqiten origjinale ose fotokopje të noterizuara, dhe të ngarkohen në SPE: - për të gjithë artikujt objekt prokurimi : “Blerje bulmet dhe nënproduktet e tij”.

Në nenin 4 pika 38 gërma “b” të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “specifikime teknike” janë: Në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë...” Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.8 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë: **“8.Operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesin -Raport/Fletë Analizë Fiziko-Kimike dhe Raport/ Fletë Analizë Mikrobiologjike, të lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi. Të cilat të jenë të lëshuara brenda 30 (tridhjetë) ditëve, para datës së hapjes së ofertave. Këto Raport/Fletë Analiza duhet të paraqiten origjinale, ose fotokopje të noterizuara, dhe të ngarkohen në SPE:**

- Për të gjithë artikujt objekt prokurimi : **“Blerje bulmet dhe nënproduktet e tij.”**

III.2.2. Në shtojcën 7 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, **“Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”** sasia e mallit që kërkohet është:

Loti II: "Blerje bulmet, qumësht, kos, djathë, gjizë "						
Nr	Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Qumesht	Sipas specifikimeve teknike	Litra	52,000	Bashkia Kamez	Brenda periudhës 12-mujore të MK
2	Kos		Kg	36,000		
3	Djath i bardhe		Kg	2,000		
4	Djath kaçkavall		Kg	200		
5	Gjize		Kg	4,1000		

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, operatori ekonomik M.C.Catering” SHPK, në përmbushje të kriterit **2.3.Kapaciteti teknik** , pika 8, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Dokumentin “Rapporto di prova RP87/24 del 03/05/24 Verbale di accertazione n. 5830 “Prove sui bitumi per usi stradali”; Richiedente: Trios sha Vaqarr Tiranë – 1000 Tirana Richiesta prove del: 29/04-2024 Campione: Bitume tipo 50/70 Commesa: [...] lëshuar nga “engineering controls”, Laboratorio Geotecnico autorizzato dal Ministero Infrastrutture a Trasporti al sensi dell’art. 39 del DPR nr. 380/2001 [...]. Dokumenti i mësipërm, është i përkthyer nga përkthyer i licensuar.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: **“Qëllim i këtij ligji është:**

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.6. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.2.7. Në neni 79, pika 1 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

III.2.8. Në nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse 16 ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.2.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.2.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të pikës 2.3. pika 8 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve ligjore të sipërpërmendura, ka përcaktuar që ofertuesit duhet të paraqesin Raport/Fletë Analizë Fiziko-Kimike dhe Raport/ Fletë Analizë Mikrobiologjike, të lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi. Të cilat të jenë të lëshuara brenda 30 (tridhjetë) ditëve, para datës së hapjes së ofertave. Këto Raport/Fletë Analiza duhet të paraqiten origjinale, ose fotokopje të noterizuara, dhe të ngarkohen në SPE. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “M.C. Catering” SHPK dhe “AGS” SHPK rezulton, se këta të fundit ka paraqitur dokumentin si më poshtë:

Operatori ekonomik “M.C. Catering” SHPK ka paraqitur:

- Raport Testimi AQS/130325/U/1/M1 “Qumesht UHT Ajka 3.5% yndyre, dt.skadence 24.09.2025, date analize 17.03.2025 (Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga AQSCERT.
- Certificate analize “Qumesht UHT Ajka 3.5% yndyre, dt.skadence 24.09.2025, date analize 26.02.2025 (Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga TENUIS LABORATORIES.
- Raport analize nr.536/1-1 “Qumesht UH4T Ajka 3.3% yndyre, dt.skadence 24.09.2025, date analize 10.03.2025 (Report Analize Mikrobiologjike) leshuar nga Vitros Lab.
- Raport analize nr.536/1-3 “Qumesht UHT Ajka 3.5% yndyre, dt.skadence 24.09.2025, date analize 18.03.2025 leshuar nga Vitros Lab.
- Raport Testitni AQS/ 130325/U/1/M2 “Kos Ajka 3.5%, yndyre dt.skadence 15.05.2025, date analize 17.03.2025 (Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga AQSCERT.
- Raport analize nr.537/ 1-2 “Kos Ajka 3.5% yndyre, dt.skadence 15.03.2025, date analize 18.02.2025 (Raport Analize Mikrobiologjike) leshuar nga Vitros Lab.
- Raport analize nr.537/ 1 -3 “Kos Ajka 3.5% yndyre, dt.skadence 15.05.2025, date analize 28.02.2025 leshuar nga Vitros Lab.
- Raport Testini .AQS/ 130325/U/ 1/M4 “Djath i bardhe Ajka dt.skadence 10.10.2025, date analize 17.03.2025 (Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga AQSCERT.
- Raport analize nr.539/1 “Djath i bardhe Ajka dt.skadence 10.10.2025, date analize 28.02.2025 (Raport Analize Mikrobiologjike) leshuar nga Vitros Lab.
- Raport analize nr.539/ 1-3 “Djath i bardhe Ajka dt.skadence 10. 10.2025, date analize 28.02.2025 leshuar nga Vitros Lab .

- Raport Testimi i AQS/130325/U/1/M5 “Djath Kackavall Ajka, dt.skadence 20.05.2026, date analize 17.03.2025 (Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga AQSCERT.
- Raport analize nr.540/1 “Djath Kackavall Ajka, dt.skadence 20.05.2026, date analize 28.02.2025 (Raport Analize Mikrobiologjike) leshuar nga Vitros Lab.
- Raport analize nr.540/ 1-3 “Djatli Kackavall Ajka, dt.skadence 20.05.2026, date analize 28.02.2025 leshuar nga Vitros Lab.
- Raport Testimi i AQS/ 130325/U/1/M3 “Gjize pa kripe Ajka, dt.skadence 14.06.2025, date analize 17.03.2025 (Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga AQSCERT.
- Raport analize nr.538/1-1 “Gjize pa kripe Ajka, dt.skadence 14.06.2025, date analize 28.02.2025 (Raport Analize Mikrobiologjike) leshuar nga Vitros Lab.
- Raport analize nr.538/ 1-3 “Gjize pa kripe Ajka, dt.skadence 14.06.2025, date analize 28.02.2025 leshuar nga Vitros Lab

Operatori ekonomik “ASG” SHPK SHPK ka paraqitur:

- Certificate analize “Qumesht UHT 3.5% yndyre, dt.skadence 03.09.2025, date analize 12.03.2025 leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Certificate analize “Qumesht UHT 3.5% yndyre, dt.skadence 03.09.2025, date analize 12.03.2025 (Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Certificate analize “Qumesht UHT 3.5% yndyre, dt.skadence 03.09.2025, date analize 06.03.2025 (Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Certificate analize “Kos lope 1 kg”, dt.skadence 03.04.2025, date analize 05.03.2025 leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Certificate analize “Kos lope 1 kg”, dt.skadence 03.04.2025, date analize 05.03.2025 (Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Certificate analize “Gjize lope 500gr”, dt.skadence 03.04.2025, date analize 05.03.2025 leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Certificate analize “Gjize lope 500 gr”, dt.skadence 03.04.2025, date analize 05.03.2025(Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Certificate analize “Djathe lope”, dt.skadence 06.08.2025, date analize 19.03.2025(Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Certificate analize “Djathe lope”, dt.skadence 06.08.2025, date analize 19.03.2025 leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Certificate analize “Djathe lope”, dt.skadence 06.03.2025, date analize 19.03.2025 leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Certificate analize “Djathe kackavall lope”, dt.skadence 05.03.2025, date analize 07.03.2025 (Raport Analize Fiziko Kimike) leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Certificate analize “Djathe lope”, dt.skadence 05.03.2025, date analize 07.03.2025 leshuar nga TENUIS LABORATORIES
- Raport Analize Fiziko Kimike“Djathe lope”, dt.skadence 06.08.2025, date analize 26.02.2025 leshuar nga Bio-V
- Raport Analize Fiziko Kimike“Djathe kackavall lope”, dt.skadence 05.03.2025, date analize 13.03.2025 leshuar nga Bio-V

KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm konstaton se, dokumentacionet e mësipërme, janë lëshuar nga laboratorë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Sa më sipër pretendimet i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “NELSA” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur Mbi Kufirin e Lartë Monetar, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë me të gjitha kushtet e përcaktuara”, me NR.REF-36976-02-06-2025, me objekt: “Blerje bulmet dhe nënproduktet e tij”, me fond limit 17,042,500 (shtatëmbëdhjetë milion e dyzet e dy mijë e pesëqind) lekë pa T.V.SH ose 171,903 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tre) Euro, zhvilluar më datë 10.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “NELSA” SHPK
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

